

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe nenit 65 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-209 mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77/16 Gusht 2010), nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 12/03 maj 2013), nenit 92, paragrafi 3 dhe nenit 114 të Ligjit Nr.04/L-093 mbi Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29 nëntor 2019 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR REGJISTRIMIN E INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKARE

KAPITULLI I DISPOZITA E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për:
 - 1.1 regjistrimin e institucioneve financiare jobankare (në vijim: IFJB) për të ushtruar veprimtari financiare;
 - 1.2 dhënien e miratimeve paraprake për transaksionet që kërkojnë miratim paraprak nga BQK gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga IFJB-të;
 - 1.3 detyrimet për njoftime në BQK gjatë ushtrimit të veprimtarisë së IFJB-ve.
2. Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë personat që aplikojnë për regjistrim në BQK, për t'u angazhuar në veprimtarinë financiare të IFJB-ve në Republikën e Kosovës, si dhe për të gjitha IFJB-të që janë të regjistruara nga BQK për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuar në Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Ligjin për Sistemin e Pagesave dhe/ose siç përcaktohet me poshtë për qëllimin e kësaj Rregullore:

1. **Institucion financiar jobankar (IFJB)** – person juridik që është i regjistruar në pajtim me legjislacion në fuqi për shoqëritë tregtare, i regjistruar nga BQK-ja për kryerjen e veprimtarive të lejuara për IFJB-të të përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe kësaj rregullore.
2. **Para elektronike** – vlera monetare e ruajtur në formë elektronike, duke përfshirë edhe formën magnetike, siç paraqitet nga kërkesa ndaj emetuesit, që emetohet pas pranimit të fondeve me qëllim të

kryerjes së transaksioneve të pagesave dhe e cila pranohet si mjet i pagesës nga personat tjerë përveç emetuesit të parasë elektronike;

3. **Lizingu** – veprimtari financiare e përcaktuar sipas Ligjit për Lizingun.
4. **Këshilltar për investime** – këshillimi për blerjen dhe shitjen e instrumenteve financiare (aksionet, obligacionet e shoqërive tregtare dhe të pushtetit vendor, bonot e thesarit dhe obligacionet e emetuara nga qeveria qendrore, instrumentet e emetuara nga BQK-ja, dëftesat tregtare, aksionet ose kuotat e fondeve të investimit, si dhe instrumente të tjera financiare, të krahasueshme me aksionet dhe obligacionet dhe që vlerësohen dhe miratohen si të tilla nga BQK-ja) me porosi të klientit si dhe studimin, përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planit të investimit të përgatitur për klientin.
5. **Faktoringu** – veprimtaria financiare e përcaktuar sipas rregullores në fuqi të BQK-së për faktoringun.
6. **Garancitë** – nënkupton çdo dokument të nënshkruar, në formë fizike apo në mënyrë elektronike, sido që të quhet apo përshkruhet, i cili krijon obligim për garantuesin që të kryejë pagesën përkundrejt prezantimit të dokumenteve të kërkuara me garancion, për sa kohë ato janë në përputhje me afatet dhe kushtet e garancionit dhe me rregullat uniforme për garancionet sipas kërkesës - URDG 758 (Uniform Rules for Demand Guarantees).
7. **Shërbimi i transferit dhe pranimit të parave ose shërbimi i pagesave për pagesat brenda dhe jashtë vendit (shërbimi i pagesave)** – çdo aktivitet, individual ose i përbashkët që mundëson ekzekutimin e transaksioneve të pagesave, duke përfshirë emetimin dhe menaxhimin e instrumenteve të pagesave, ato aktivitete që mundësojnë vendosjen dhe tërheqjen e parasë së gatshme, dhe çdo shërbim tjetër funksional që ndërlidhet me këtë. Ky term nuk përfshin vetëm ofrimin e shërbimeve “on line” apo të telekomunikimit.
8. **Llogari e pagesës** – një llogari e hapur në IFJB e regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së pagesave dhe/ose parasë elektronike, në emër të një ose më shumë përdoruesëve të shërbimeve të pagesave, e cila përdoret për kryerjen e transaksioneve të pagesave;
9. **Përdorues të shërbimeve të pagesave** – një person fizik ose juridik që përdor ose e ka përdorur një shërbim të pagesave në cilësinë e një paguesi dhe/ose të paguari;
10. **Paguesi** – personi që mban një llogari të pagesave dhe lejon një urdhërpagesë duke debituar atë llogari; apo, kur nuk ka llogari të pagesave, personi që inicion transferin e fondeve në përfitim të të paguarit;
11. **I paguari** – personi i cili synohet të jetë përfituesi përfundimtar i fondeve;
12. **Këmbimi i valutave** – veprimtaria financiare e shitblerjes së valutave në para të gatshme, ushtruar nga IFJB-të në emër dhe për llogari të saj, në mënyrë të vazhdueshme dhe për qëllime fitimi.
13. **Agjent** – person i organizuar si shoqëri tregtare i përcaktuar sipas Rregullores së BQK-së për Agjent dhe Nënkontraktimin e Aktiviteteve të Ofruesëve të Shërbimeve të Pagesave.
14. **Pronar përfitues** – person që posedon aksione (ka pronësi) në IFJB në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, së bashku ose në bashkëveprim me persona tjerë;
15. **Drejtor** - nënkupton çdo person të emëruar nga aksionarët për të shërbyer si anëtar i Bordit të Drejtorëve të IFJB-ve.
16. **Drejtor i pavarur** – nënkuptohet drejtori që është i pavarur nga menaxhmenti i lartë apo personat e ndërlidhur me menaxhmentin e lartë.
17. **Person i ndërlidhur** – çdo person që ka së paku njërin nga marrëdhëniet e mëposhtme me IFJB-në:

14.1 çdo menaxher i lartë i IFJB-së;

14.2 çdo person që është i lidhur me menaxherin e lartë të IFJB-së me anë të martesës ose afërsisë së gjakut deri në shkallë të dytë.

18. Menaxher i lartë – kryeshefi ekzekutiv, zyrtari kryesor për financa, zyrtari kryesor për operacione, zyrtari kryesor për rrezik të IFJB-së si dhe çdo person i cili i:

15.1 raporton drejtpërsëdrejti bordit ose merr pjesë apo ka autoritet për të marrë pjesë në funksionet kryesore politikëbërëse të IFJB-së, dhe/ose

15.2 është caktuar si menaxher i lartë nga BQK-ja.

19. Kapital apo kapital aksionar - vlera neto apo fondet e institucionit që paraqesin dallimin mes pasurisë dhe detyrimeve në përputhje me bilancin e gjendjes, i cili pasqyron standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

20. Person - nënkupton çdo person fizik apo juridik.

KAPITULLI II REGJISTRIMI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKARE

Neni 3

Regjistrimi dhe veprimtaritë financiare

1. BQK-ja ka përgjegjësi ekskluzive për:

1.1 Regjistrimin e IFJB për të ushtruar, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, një ose disa nga veprimtaritë financiare të më poshtme:

1.1.1 dhënia e kredive;

1.1.2 lizingu - lidhja e marrëveshjes për hua dhe qira;

1.1.3 transferi dhe pranimi i parave ose shërbimi i pagesave për pagesat brenda dhe jashtë vendit (shërbim i pagesave);

1.1.4 këmbimi valutor;

1.1.5 faktoringu;

1.1.6 garancitë;

1.1.7 këshilltarë për investime;

1.1.8 emetimi i parasë elektronike;

1.2 Regjistrimin e agjenteve për IFJB që ushtrojnë veprimtarin e shërbimit të pagesave dhe/ose emetimin e parasë elektronike.

1.2.1 IFJB-të që janë të regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike nuk mund të emetojnë para elektronike nëpërmjet agjentëve, por mund të shpërndajnë dhe/ose të ripaguajnë fondet nëpërmjet një ose më shumë agjentëve, të cilët veprojnë për llogari të saj.

2. IFJB-të përshtatshmërisht mund të angazhohen edhe në veprimtaritë vijuese, pa qenë subjekt i regjistrimit:

2.1 shërbimi i pagesave lidhur me kreditë e dhëna klientëve;

- 2.2 përfitimin e fondeve me anë të granteve, apo/dhe huazimeve nga institucionet financiare që ofrojnë huadhënie financiare, me qëllim të huadhënies apo për përdorimin e tyre;
- 2.3 huazimin nga dhe vendosjen e fondeve në tregje dhe institucione të licencuara nga BQK-ja me qëllim të menaxhimit të likuiditetit të tyre; dhe
- 2.4 ofrimin e shërbimeve teknike, profesionale dhe trajnimin e klientëve të tyre lidhur me shërbimet financiare.
3. IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike, me të njëjtin regjistrim mund ushtrojnë edhe veprimtarinë e shërbimit të pagesave me njoftim paraprak të BQK-së.
4. IFJB-të që ushtrojnë veprimtarinë e shërbimit të pagesave dhe/ose emetimin e parasë elektronike, me miratimin paraprak të BQK-së mund të ushtrojnë edhe veprimtaritë financiare të mëposhtme të lejuara për IFJB-të:
- 4.1 dhënie të kredive me kushtet e si në vijim:
- 4.1.1 dhënia e kredive nuk mund të financohet nga fondet e mbajtura në llogaritë e pagesave të përdorueseve të shërbimeve të pagesave;
- 4.1.2 kredia jepet ekskluzivisht me qëllim ekzekutimin e transaksionit të pagesës dhe nuk mund të tërhiqet në para të gatshme;
- 4.1.3 kredia e dhënë për kryerjen e pagesave duhet të shlyhet brenda një periudhe të shkurtër kohe, që në asnjë rast nuk do të tejkalojë dymbëdhjetë muaj;
- 4.1.4 kredia nuk do të jepet nga fondet e pranuar ose të mbajtura për qëllim të ekzekutimit të një transaksioni pagese; dhe
- 4.1.5 shuma e përgjithshme e kredive të lëshuar nga IFJB-ja nuk nuk cënon në asnjë rast kapitalin e kërkuar (kapitali rregullator) dhe përmbushjen e kërkesave mbikëqyrëse të BQK-së.
- 4.2 këmbim valutë;
- 4.3 këshilltar për investime;
5. IFJB-të që ushtrojnë veprimtarinë e shërbimit të pagesave dhe/ose emetimin e parasë elektronike mund të hapin llogari të pagesave në emër të një ose më shumë përdorues të shërbimeve të pagesave. Hapja e llogarive të pagesave mund të bëhet vetëm nëse ofrohet edhe ndonjë instrument i pagesës.
6. IFJB-të e regjistruara për të ushtruar veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike nuk do të marrin depozita nga publiku apo fonde tjera të ripagueshme.
7. IFJB-të që ushtrojnë veprimtarinë e shërbimit të pagesave dhe/ose emetimin e parasë elektronike mund të licencohen edhe si operator të sistemit të pagesave.
8. IFJB pasi të regjistrohet nga BQK-ja, mund të fillojë me kryerjen e veprimtarive financiare për të cilat kanë marrë miratim nga BQK.
9. Përveq nëse përcaktohet ndryshe me këtë rregullore, IFJB-të që kërkojnë të angazhohen në veprimtari tjera financiare të lejuara, përveç atyre që janë të autorizuar në regjistrim ose të miratuara paraprakisht, duhet të marrin miratim paraprak nga BQK-ja.

Neni 4 **Kërkesat për kapital**

1. Shuma minimale e kapitalit të kërkuar për regjistrim dhe të mirëmbajtur për IFJB-të është si në vijim:

- | | |
|------------------------------------|---|
| 1.1. dhënia e kredive | – 300,000.00 (treqind mijë) Euro; |
| 1.2. lizingu | – 150,000.00 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Euro; |
| 1.3. shërbim i pagesave | – 125,000.00 (njëqind e njëzet e pesë mijë) Euro; |
| 1.4. këmbimi valutor | – 10,000.00 (dhjetë mijë) Euro; |
| 1.5. faktoringu | – 150,000.00 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Euro; |
| 1.6. garancitë | – 150,000.00 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Euro; |
| 1.7. këshilltarë për investime | – 100,000.00 (njëqind mijë) Euro; |
| 1.8. emetimi i parasë elektronike; | – 350,000.00 (treqind e pesëdhjetë mijë) Euro |
2. IFJB-të që kërkojnë të angazhohen në më shumë se një veprimtari, kapitali minimal i kërkuar dhe i mirëmbajtur do të jetë sipas shumave të përcaktuara për secilën veprimtari të kërkuar në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni. Përcaktimet e këtij paragrafi nuk aplikohen për IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike, të cilat ushtrojnë edhe shërbimit të pagesave si dhe për IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave dhe/ose emetimit të parasë elektronike të cilat angazhohen edhe në veprimtarinë e dhënisë së kredive sipas përcaktimeve të nenit 3 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1 të kësaj rregullore.
 3. Përveç kapitalit të përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, IFJB-të duhet të ketë edhe një fond shtesë për shpenzime fillestare, për të mbuluar shpenzimet e themelimit, funksionimit dhe administrimit, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i vogël se dhjetë për qind (10%) e kapitalit të përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni. Kërkesa për fond shtesë sipas këtij paragrafi, aplikohet vetëm për aplikacionet fillestare për regjistrim si IFJB.
 4. BQK, bazuar në vlerësimin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut, të dhënave mbi rrezikun e humbjeve dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm të institucionit, mund të kërkojë në çdo rast nivele shtesë kapitali deri në 20% (njëzet për qind) mbi nivelin e kapitalit fillestar minimal të kërkuar.
 5. Total kapitali në raportin me total mjetet e IFJB-së nuk duhet të jetë më i vogël se 10% (dhjetë për qind). Ky paragraf nuk aplikohet për IFJB-të e regjistruara vetëm për ofrimin e veprimtarisë së këmbimit të valutave.
 6. IFJB e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave dhe/ose emetimit të parasë elektronike, e cila kërkon që veprimtarinë ta kryej përmes një ose më shumë agjenteve, shuma minimale e kapitalit të paguar sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të plotësohet në vazhdimësi për 2,000 (dy mijë) Euro, për secilin agjent.
 7. Pajisje elektromekanike për realizimin e transaksioneve automatike (ATM, terminal i pagesave etj), për qëllime të kësaj rregullore nuk konsiderohen si zyra të IFJB-ve dhe/ose zyre e agjentit të IFJB-ve.
 8. Kapitali i kërkuar sipas paragrafit 6 të këtij neni mund të sigurohet gjithashtu me Garancion bankar dhe/ose letër të parevokueshme të kredisë, që referohet në këtë paragraf si “letër me vlerë”
 - 8.1. IFJB duhet të sigurojë letrën me vlerë në shumë prej 2,000 (dy mijë) Euro për çdo agjent shtesë.
 - 8.2. Letra me vlerë duhet të plotësohet në vazhdimësi për çdo agjent të ri për shumën e lartpërmendur;
 - 8.3. Letra me vlerë duhet të jetë në formë të pranueshme për BQK-në dhe duhet të përcaktojë BQK-në si përfitues në rast të ndonjë ankese ndaj IFJB-së për të siguruar përmbushjen e obligimeve nga ana e IFJB-së për sa i përket pranimit, trajtimit, transmetimit dhe pagesës së parave në lidhje me shërbimin e pagesave;
 - 8.4. Çdo kërkesë ndaj instrumentit të sigurimit mund të jetë subjekt i shqyrtimit administrativ;
 - 8.5. Letrat me vlerë duhet të vazhdojnë të mbahen valide për një periudhë jo më pak se një vit.

9. Pagesa e kapitalit minimal dhe çdo shtesë e mëvonshme lidhur me të, duhet të bëhet në para të gatshme dhe shoqërohet me paraqitjen në BQK të informatave lidhur me burimin e këtij kapitalit dhe dokumentin bankar që vërteton pagesën e kapitalit (nëse është e aplikushme), ashtu siç është e përcaktuar në nenin 5 paragrafi 3 nënparagrafët 3.3 dhe 3.4 të kësaj rregullore.
10. BQK-ja ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme lidhur me burimin/et e fondeve, që do të shërbejnë si kapital fillestar ose si shtesë e mëvonshme e kapitalit.
11. Burimet e fondeve të kapitalit duhet të jenë të ligjshme dhe nuk duhet të rrjedhin nga huat nga publiku, kreditë dhe/ose fonde të tjera, origjina e të cilave është e paligjshme.

Neni 5

Kërkesa e përgjithshme për regjistrim

1. Të interesuarit për regjistrim si IFJB duhet të përmbushin të gjitha kërkesat sipas Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare që janë të nevojshme për procesin e aplikimit sipas akteve të brendshme të BQK-së. Aplikuesi mund të kërkojë format e nevojshme të aplikimit dhe udhëzimet për plotësimin e tyre nga BQK-ja vetëm pas takimit informues të mbajtur me përfaqësuesit e BQK-së.
2. Aplikacioni nënshkruhet nga aksionari/ët themelues apo përfaqësuesi ligjor i tyre dhe dorëzohet në BQK, me prezencë fizike të aksionarit/ëve themelues ose përfaqësuesit të aksionarit/ëve themelues të propozuar të IFJB-së. Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentacionin e plotë që kërkohet me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe me këtë Rregullore.
3. Kërkesat për regjistrim si IFJB duhet të jenë në formë të shkruar, e shoqëruar nga formularët e plotësuar sipas formatit të BQK-së dhe do të përfshijë dokumentacionet / informacionet vijuese:
 - 3.1. dokumentet e aplikuesit (aktin e themelimit dhe/ose statuti) ;
 - 3.2. certifikata e regjistrimit të biznesit, në të cilin janë përcaktuar veprimtaria/të për të cilën/at subjekti kërkon të regjistrohet në BQK;
 - 3.3. listën e aksionarëve dhe pronarëve përfitues të aplikuesit për regjistrim si IFJB, duke cekur emrin, nacionalitetin, adresën, historikun afarist dhe profesional për dhjetë (10) vitet e fundit si dhe posedimin përkatës të aksioneve së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm (për aksionarët kryesor):
 - 3.3.1. Për aksionarët që janë të organizuar si shoqëri tregtare (persona juridik dhe/ose personat fizik) sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare:
 - 3.3.1.1. statuti dhe dokumentacioni i regjistrimit të biznesit (për personat juridikë të huaj – aktet e barazvlefshme / ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit / juridiksionit të huaj);
 - 3.3.1.2. vendimi i organit vendimmarrës të personit juridik dhe/ose personat fizik të organizuar si shoqëri tregtare për pjesëmarrjen në kapitalin e IFJB-së;
 - 3.3.2. Për personat fizik, që nuk janë të organizuar si shoqëri tregtare:
 - 3.3.2.1. dokumentin e identifikimit i lëshuar nga shteti, shtetas i të cilit është aksionari i propozuar, dhe adresa e saktë të vendbanimit; dhe
 - 3.3.2.2. listën e bizneseve në të cilat ka pjesëmarrje, certifikatat e regjistrimit të biznesit për secilin rast, si dhe të dhëna mbi ndonjë rast paaftësie paguese dhe/ose falimentimi;

- 3.3.3. vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit ku ka vendbanimin aksionari:
 - 3.3.3.1. se personi nuk është në ndjekje penale;
 - 3.3.3.2. se personi nuk është në gjykim për vepra penale;
 - 3.3.3.3. se personi nuk është i dënuar penalisht;
 - 3.3.3.4. nga Oda e Përmbanuesëve Privat, se personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.
 - 3.3.3.5. se personi nuk ka dosjet personale të falimentimit, diskualifikimi nga ushtrimi i profesionit apo përfshirjen e kaluar ose të tashme në funksion menaxhues të ndonjë korporate ose organ tjetër të shoqërisë tregtare, që i është nënshtruar procedurave të paaftësisë paguese
 - 3.3.3.6. pëlqimin/autorizimin që i lejonë BQK-së verifikim të të kaluarës penale dhe marrjen e informacioneve tjera lidhur me informatat e paraqitura;
 - 3.3.3.7. dokumentet e kërkuara sipas këtij paragrafi duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e aplikimit në BQK.
- 3.4. shumën e kapitalit të zotuar të aplikuesit për regjistrim si IFJB, duke përfshirë dëshminë e pagesës si dhe dokumentacionin për burimin e tij:
 - 3.4.1. deklaratë noteriale të aksionarëve për burimin e kapitalit të paguar dhe se burimi i këtij kapitali nuk është hua nga publiku, kredi dhe/ose fonde të tjera, origjina e të cilave është e paligjshme.
 - 3.4.2. për aksionarët të organizuar si shoqëri tregtare, deklaratë noteriale të aksionarëve mbi burimin e kapitalit fillestar të paguar dhe për çdo shtesë të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë, duhet shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 3.4.2.1. evidencë për burimin e krijimit të kapitalit, si raporti i auditorit të jashtëm të pavarur, pasqyrat financiare vjetore, dhurata apo burime të tjera të destinuara për t'u përdorur në blerjen e aksioneve të aplikuesit;
 - 3.4.2.2. vërtetim i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili jep të dhëna për bilancin e personit juridik dhe për përmbushjen e detyrimeve tatimore.
 - 3.4.3. për aksionarët personat fizik, deklaratë noteriale të aksionarëve mbi burimin e kapitalit fillestar të paguar dhe për çdo shtesë të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë, duhet shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 3.4.3.1. evidencë për burimin e krijimit të kapitalit si blerje dhe shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka apo vërtetime të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;
 - 3.4.3.2. vërtetime që dëshmojnë përmbushjen e detyrimeve tatimore;
 - 3.4.3.3. kontributet për kapitalin e aplikuesit nuk duhet të burojnë nga fondet e marra hua nga publiku, kredi bankare si dhe fonde të tjera, origjina e të cilave është e paligjshme.
- 3.5. emrin, nacionalitetin, vendbanimin, kualifikimet dhe përvojën e drejtorit dhe/apo menaxherit të lartë të IFJB-së, të cilat duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 3.5.1. vendimin e organit vendimmarrës për emërim;
 - 3.5.2. dokumentin e identifikimit;
 - 3.5.3. dëshmi për përgatitjen shkollore universitare;
 - 3.5.4. vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit ku ka vendbanimin për drejtorët, menaxherët e lartë dhe (nëse është e aplikueshme) përfaqësuesin ligjor:

- 3.5.4.1. se personi nuk është në ndjekje penale;
 - 3.5.4.2. se personi nuk është në gjykim për vepra penale;
 - 3.5.4.3. se personi nuk është i dënuar penalisht; dhe
 - 3.5.4.4. nga Oda e Përmbaresëve Privat, se personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.
 - 3.5.4.5. se personi nuk ka dosjet personale të falimentimit, diskualifikimi nga ushtrimi i profesionit apo përfshirjen e kaluar ose të tashme në funksion menaxhues të ndonjë korporate ose organ tjetër sipërmarrës, që i është nënshtruar procedurave të paafëtisë paguese
 - 3.5.4.6. vërtetime që dëshmojnë përmbushjen e detyrimeve tatimore;
 - 3.5.4.7. pëlqimin/autorizimin që i lejonë BQK-së verifikim të të kaluarës penale dhe marrjen e informacioneve tjera lidhur me informatat e paraqitura;
 - 3.5.4.8. dokumentet e kërkuara sipas këtij paragrafi duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e aplikimit në BQK.
- 3.6. Plani i biznesit me përmbajtje si më poshtë:
- 3.6.1. struktura e organizimit të aplikuesit për regjistrim si IFJB dhe niveli i përgjegjësisë/ve;
 - 3.6.2. veprimtaritë financiare që parashikon të kryejë, vlerësimi i tregut, konkurrentët, karakteristikat e tregut dhe tendencat e zhvillimit të tij;
 - 3.6.3. skema e realizimit të veprimtarisë dhe përshkrim i masave për ruajtjen/sigurimin e fondeve të klientëve (aplikohet vetëm për aplikuesit për regjistrim si IFJB me veprimtari të emetimit të parasë elektronike dhe/ose shërbimit të pagesave);
 - 3.6.4. identifikimi i rreziqeve, ndaj të cilave aplikuesit për regjistrim si IFJB është e ekspozuar, duke përfshirë dhe zyrat/agjentët;
 - 3.6.5. parashikimi i gjendjes financiare të aplikuesit për regjistrim si IFJB për 3 (tre) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së tij pas regjistrimit (pasqyrat financiare të parashikuara);
 - 3.6.6. burimet e financimit dhe struktura e mjeteve për 3 (tre) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë pas regjistrimit;
 - 3.6.7. parimet, në bazë të të cilave është përgatitur plani i biznesit;
 - 3.6.8. një informacion lidhur me zyrat ku aplikuesit për regjistrim si IFJB parashikon të kryejë veprimtarinë/të; dhe
 - 3.6.9. një parashikim në lidhje me zbatimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës për 3 (tre) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë.
 - 3.6.10. një përshkrim të pajisjeve teknike dhe burimeve të nevojshme për të kryer veprimtarinë, duke përfshirë këtu sisteme të përshtatshme kompjuterike, informatike, kontabël dhe të regjistrimit;
- 3.7. aktet e brendshme rregullative (rregulloret dhe/ose udhëzimet e brendshme), të miratuara nga organet vendimmarrëse për:
- 3.7.1. veprimtarinë operacionale të aplikuesit për regjistrim si IFJB;
 - 3.7.2. sistemin e kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedura efektive të kontrollit të brendshëm, dhe në veçanti, procedurat që do të përdoren nga agjentët (në rastet kur aplikuesi kërkon regjistrim për veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike dhe/ose shërbimit të pagesave), për sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullative për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
 - 3.7.3. mbrojtjen e konsumatorit;
 - 3.7.4. menaxhimin e rreziqeve;

- 3.7.5. parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, duke përfshirë një program masash në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - 3.7.6. një përshkrim të planit për vazhdimi të punës që përfshin një identifikim të qartë të operacioneve kritike, planin efektiv të emergjencave dhe procedur për testim dhe rishikim të vazhueshëm të këtyre planeve;
 - 3.7.7. organizimin, funksionimin dhe menaxhimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë mënyrën e mbrojtjes/sigurisë së informacionit dhe të dhënave të klientëve.
- 3.8. në çdo rast kur aplikuesi është një institucion financiar i huaj, që aplikon të themelojë një IFJB në Kosovë, nevojitet një deklaratë nga mbikëqyrësi në vendin amë, nëse është e aplikueshme, se nuk ka asnjë kundërshtim për themelimin e propozuar të operacioneve në Kosovë dhe se ushtron mbikëqyrje të konsoliduar për aplikuesit për regjistrim si IFJB;
 - 3.9. listën e tarifave të planifikuara për produkte dhe shërbimet e ofruara;
 - 3.10. dëshminë e pagesës së tarifës për regjistrim si IFJB;
 - 3.11. informata shtesë nëse BQK e konsideron të arsyeshme.
- 4. Institucionet për ofrimin e shërbimit të pagesave jashtë vendit duhet të kenë marreveshje me një sistem ndërkombëtar të autorizuar për transfere elektronike.
 - 5. Kërkesat e këtij neni aplikohen përshtatshëm për aplikuesit për regjistrim si IFJB për regjistrim të ushtrimit të veprimtarisë së këmbimit valutor si veprimtari të vetme;
 - 6. Dokumentacioni sipas këtij neni duhet të jetë në një nga dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja, të ndryshme nga Republika e Kosovës, dokumentacioni duhet të jetë i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse të shteteve përkatëse.

Neni 6

Procedura dhe kushtet e regjistrimit

- 1. BQK-ja bën shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur në perpërputhje me kërkesat e kësaj Rregullore.
 - 1.1. BQK-ja brenda 90 ditësh pas ditës së pranimit të aplikacionit, e shqyrton dokumentacionin e dorëzuar dhe e njofton aplikuesin me shkrim nëse dokumentacioni është apo nuk është kompletuar.
 - 1.2. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i kompletuar dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara me këtë Rregullore, BQK-ja do të njoftojë aplikuesin për mangësitë ose për mospërputhjet me dispozitat e kësaj Rregullore së bashku me kërkesën për informata ose dokumente shtesë që kërkohen. Afati për paraqitjen e informatave ose dokumenteve shtesë është jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit sipas këtij paragrafi.
 - 1.3. Nëse informatat ose dokumentet shtesë të kerkuara sipas nën paragrafit 1.2 të paragrafit 1 të këtij neni janë paraqitur brenda afatit, BQK do ta njoftoj palën se aplikacioni është i kompletuar.
 - 1.4. BQK-ja ndërpret procedurat e shqyrtimit të aplikacionit për regjistrim në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për regjistrim nuk plotësohet nga aplikuesi brenda 90 ditësh pas datës së njoftimit sipas nën paragrafit 1.2 të paragrafit 1 të këtij neni. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të aplikacionit për regjistrim, BQK-ja e njofton me shkrim aplikuesin.
 - 1.5. BQK-ja nxjerr vendim me të cilin aprovon apo refuzon regjistrimin si institucion financiar jobankar brenda 90 ditësh nga data e njoftimit të aplikantit se aplikacioni për regjistrim është i kompletuar. Për vendimin e marrë BQK-ja menjëherë e informon aplikuesin. Me marrëveshje të

ndërsjellë ndërmjet BQK-së dhe aplikantit, periudha për marrjen e vendimit sipas këtij nenparagrafi, mund të zgjatet edhe deri 90 ditë tjera.

1.6. Gjatë periudhës së shqyrtimit të aplikacionit BQK-ja mund të kërkojë informata shtesë apo ndryshime/përmirësime të caktuara kur vlerësohen të arsyeshme.

2. Nëse BQK konsideron se informacioni i dhënë në njoftim është jo i plotë ose i pasaktë, BQK mund të ndërmarrë veprime të mëtejshme për të verifikuar informacionin.

3. Kushtet për miratimin apo refuzimin e regjistrimit:

3.1. BQK-ja merr vendim për miratimin e regjistrimit nëse konstaton se janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

3.1.1. aksionarët të kenë reputacion të mirë, burim të ligjshëm të fondeve të kapitalit, të kenë mundësi financiare për investimin e fondeve të planifikuara, si dhe mundësi financiare për realizimin e financimeve të nevojshme për vazhdimin e qëndrueshëm të veprimtarisë së institucionit;

3.1.2. shuma e kapitalit aksionar të zotuar është paguar;

3.1.3. kualifikimet, përvoja dhe reputacioni i anëtarëve të bordit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të jetë e përshtatshme për realizimin e planit të biznesit siç është përcaktuar në nenin 12 të kësaj rregullore;

3.1.4. plani i biznesit i paraqitur duhet të jetë real dhe konkurrues në treg dhe gjendja e pritshme financiare e IFJB-së së propozuar të jetë e kënaqshme.

3.2. BQK-ja refuzon kërkesën për miratim të regjistrimit, në rastet e mëposhtme:

3.2.1. nuk plotësohen kushtet e përcaktuara më lartë, në nenparagrafin 3.1 të paragrafit 3 të këtij neni;

3.2.2. njëri nga aksionarët ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paafësisë paguese përfshirë administrimin zyrtarë ose falimentimin;

3.2.3. nëse prejardhja e kapitalit aksionar të investuar, nuk është e qartë për BQK-në;

3.2.4. gjatë aplikacionit janë deklaruar informata të rrejshme/falsifikuara.

3.3. BQK, për të kryer vlerësimet e përcaktuara në këtë nen, përveç shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, bashkëpunon dhe mund të kërkojë informacion nga autoritetet mbikëqyrëse homologe dhe institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik, parandalimin e pastrimit të parave; organet tatimore; Autoriteti i Konkurrencës ose ndonjë tjetër institucion relevant vendor apo ndërkombëtar.

3.4. Në vendimin për refuzimin e miratimit për regjistrim do të sqarohen arsyet në mbështetje të të cilave është refuzuar miratimi i regjistrimit.

Neni 7

Karakteristikat e regjistrimit

1. Regjistrimi miratohet për një periudhë të pacaktuar kohore dhe nuk është i transferueshëm.

2. Pas regjistrimit, IFJB fillon veprimtarinë brenda 6 (gjashtë) muajsh nga dita e njoftimit për regjistrimin. Për IFJB-të e regjistruara për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave dhe/ose emetimit të parasë elektronike, afati për fillimin e veprimtarisë është 12 (dymbëdhjetë) muaj nga dita e njoftimit për regjistrim.

3. Nëse IFJB-të nuk fillojnë veprimtarinë sipas afateve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, regjistrimi i miratuar nga BQK revokohet. Institucioni mund të riaplikojë për regjistrim.
4. Certifikata e regjistrimit të IFJB-ve, lëshohet në pajtim me Rregulloren për lëshimin e certifikatave të licencimit apo regjistrimit të institucioneve financiare.
5. IFJB, para se të fillojë me veprimtarinë financiare, duhet ta njoftojë BQK-në për përgatitjet e bëra dhe gatishmërinë për të filluar me ushtrimin e veprimtarisë, për krijimin e hapësirës dhe infrastrukturës së përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë, përfshirë edhe instalimin e sistemit operativ të teknologjisë informative.

Neni 8 Tarifat

1. IFJB që aplikon për regjistrim duhet të paguajë tarifën për regjistrim, sipas shumës së përcaktuar nga BQK-ja. Tarifa e paguar nuk rimburohet edhe në rast të refuzimit të kërkesës për regjistrim.
2. Pas regjistrimit IFJB-ja duhet të paguajë tarifat e tjera sipas shumës së përcaktuar nga BQK-ja.

Neni 9 Revokimi ose pezullimi i regjistrimit

1. Regjistrimi i IFJB mund të revokohet vetëm me vendim të BQK-së, për një apo më shumë prej këtyre arsyeve:
 - 1.1. nëse IFJB-ja nuk ka filluar ushtrimin e veprimtarisë brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 7 të kësaj rregullore ose:
 - 1.1.1. IFJB ka ndërprerë ushtrimin e veprimtarive për të cilat është regjistruar në BQK, për më shumë se 6 (gjashtë) muaj pa ndërprerje;
 - 1.1.2. IFJB e regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave dhe/ose emetimit të parasë elektronike ka ndërprerë ofrimin e shërbimit të pagesave dhe/ose emetimit të parasë elektronike për një periudhë prej më shumë se një (1) muaji, pa ndërprerje;
 - 1.2. ekzistojnë të dhëna të besueshme se aksionarët, drejtorët dhe/ose menaxherët e lartë janë përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit;
 - 1.3. nëse BQK-ja ka miratuar planin që IFJB-ja të përfundojë veprimtarinë në Kosovë dhe i është përmbajtur atij plani;
 - 1.4. nëse IFJB-ja ka shkelur ndonjë dispozitë ligjore, ndonjë urdhëresë ose rregullore të BQK-së apo ndonjë kusht ose kufizim, që ndërlidhet me autorizimin e lëshuar nga BQK-ja edhe pas paralajmërimit të BQK-së;
 - 1.5. nëse IFJB-ja është angazhuar në praktika të pasigurta ose të pashëndosha sipas gjykimit të BQK-së;
 - 1.6. nuk përmbush më kushtet në bazë të të cilave ai është regjistruar;
 - 1.7. nëse regjistrimi është marrë në bazë të informacionit të rrejshëm të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës ose që ka të bëjë me të.

2. Regjistrimi i IFJB do të revokohet me vendim të BQK-së nëse vlerësohet se IFJB-ja është josolvente ose arsyeshmërisht pritet të bëhet josolvente.
3. Për qëllimet e këtij neni, “josolvent” do të thotë se IFJB-ja nuk është duke i paguar detyrimet e saj ose vlera e detyrimeve të IFJB-së tejkalon vlerën e mjeteve të saj. Vlera e mjeteve, detyrimeve dhe kapitalit të IFJB-së përcaktohet në përputhje me standardet e vlerësimit dhe procedurat e përcaktuara nga BQK-ja.
4. BQK-ja kur e vlerëson të arsyeshme, mund të vendos për pezullimin e regjistrimit të IFJB-së. Në raste të tilla periudha dhe kushtet tjera lidhur me pezullimin, përcaktohen me vendim të BQK-së.

KAPITULLI III

TRANSAKSIONET QË KËRKOJNË MIRATIM PARAPRAK

Neni 10

Miratimet paraprake

1. Transaksionet e IFJB-ve që kërkojnë miratim paraprak nga BQK, janë si në vijim:
 - 1.1. ndryshimi i emrit;
 - 1.2. ndryshimet në dokumentin e themelimit dhe/ose statutin;
 - 1.3. rritja e kapitalit aksionar;
 - 1.4. zvogëlimi i kapitalit aksionar;
 - 1.5. të gjitha transaksionet dhe veprimet lidhur me kapitalin aksionar që sjellin te ndryshimi i listës së aksionarëve, të cilët posedojnë dhjetë përqind (10%) apo më shumë të kapitalit aksionar dhe/apo të drejtave të votës në IFJB;
 - 1.6. emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë;
 - 1.7. zgjerimi i veprimtarisë;
 - 1.8. hapja dhe zhvendosja e zyrave brenda vendit;
 - 1.8.1.për qëllime të kësaj rregullore, zhvendosja e zyrave të IFJB-ve brenda vendit nënkupton ndryshimin e lokacionit të zyrës përkatëse brenda territori të të njëjtës komunë.
 - 1.9. mbyllja e zyrave brenda vendit;
 - 1.10. shitja apo transferimi (i plotë apo i pjesshme) i veprimtarisë (portofolis) të IFJB një entiteti tjetër;
 - 1.11. bashkimi dhe/ose përvetësimet;
 - 1.12. shpërndarja e dividendës.
2. BQK miraton ose refuzon transaksionin, sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda 30 ditëve nga data e kompletimit të kërkesës, mbështetur në dokumentacionin e përcaktuar në paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni.
3. Për miratimin e transaksioneve sipas paragrafit 1 të këtij neni, IFJB paraqet kërkesë me shkrim të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 3.1. ndryshimi i emrit:
 - 3.1.1. vendimin e organit vendimmarrës; si dhe
 - 3.1.2. arsyetimi me shkrim për ndryshimin e emrit.
 - 3.2. ndryshimet në dokumentin e themelimit dhe/ose statutin:

- 3.2.1. vendimin e organit vendimmarrës;
 - 3.2.2. dokumentin e themelimit dhe/ose statutin e ndryshuar;
 - 3.2.3. arsyetimi me shkrim për ndryshimin e dokumentit të themelimit dhe/ose stautit.
- 3.3. rritja e kapitalit aksionar:
- 3.3.1. nëse rritja e kapitalit aksionar të IFJB-së bëhet nga burime të brendshme të tij:
 - 3.3.1.1. deklaratën në lidhje me burimin e rritjes së kapitalit;
 - 3.3.1.2. raporti i auditorit të jashtëm të IFJB-së për vitin paraprak;
 - 3.3.1.3. pasqyrat financiare të peridhës së fundit të raportuara në BQK, të cilat vërtetojnë mjaftueshmërinë e këtyre burimeve brenda strukturës së kapitalit të IFJB-së.
 - 3.3.2. nëse rritja e kapitalit aksionar të IFJB-së bëhet nga burimet e jashtme të tij, aplikohen kërkesat e nenit 5 paragrafi 3.3 dhe 3.4 të kësaj rregullore.
- 3.4. zvogëlimi i kapitalit aksionar:
- 3.4.1. vendimin e organit vendimmarrës;
 - 3.4.2. një përshkrim të ndikimit të këtij ndryshimi në kërkesat për kapital sipas kësaj rregullore;
 - 3.4.3. arsyetimi me shkrim për zvogëlimin e kapitalit aksionar.
- 3.5. për ndryshimin e pronësisë së aksionarëve, që posedojnë dhjetë përqind (10%) apo më shumë të kapitalit aksionar dhe/apo të drejtave të votës në kompani:
- 3.5.1. raportin e kompanisë aksionare, në rastin e aksionarëve të organizuar si shoqëri tregtare apo CV-të e aksionarëve individual sipas formës së BQK;
 - 3.5.2. emrin, nacionalitetin, vendbanimin dhe historikun afarist the profesional për dhjetë (10) vitet e fundit të paraqitësit të kërkesës, dhe çdo pronari përfitues të paraqitësit të kërkesës që, si rezultat i transaksionit, do të përfitonte në mënyrë indirekte pesë përqind (5%) ose më shumë të interesave të kapitalit të IFJB-së si dhe informatat / dokumentacioni e kërkuar në nenin 5, paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 të kësaj rregullore;
 - 3.5.3. listën e shoqërive tregtare në të cilat pronarët e propozuar, duke përfshirë pronarët përfitues (siç përshkruhet me lartë), kanë pjesëmarrje, duke specifikuar nivelin e pjesëmarrjeve të këtyre dhe adresat e regjistruara të këtyre shoqërive tregtare;
 - 3.5.4. për çdo person juridik, pasqyrat e audituara financiare (të audituara nëse është e aplikueshme) për tri (3) vitet e fundit;
 - 3.5.5. burimin dhe shumën e fondeve që shfrytëzohen në ushtrimin e përvetësimit ashtu siç përcaktohet në nenin 5 paragrafi 3 nënparagrafi 3.4 të kësaj rregullore; dhe
 - 3.5.6. në çdo rast kur përvetësimi i aksioneve do të ndikonte që IFJB të bëhet një subjekt i varur i një institucioni financiar të huaj, një deklaratë nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës i vendin amë se nuk ka kundërshtime për fillimin e veprimtarisë në Kosovë dhe se ushtron mbikëqyrje globale të konsoliduar ndaj IFJB-së të themeluar në Kosovë, nëse është e aplikueshme;
 - 3.5.7. marrëveshjen e noterizuar, të nënshkruar për ndryshimin e pronësisë së aksioneve.
- 3.6. për emërimin e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë:
- 3.6.1. dokumentacionin e kërkuar në nenin 5 paragrafi 3 nënparagrafi 3.5 të kësaj rregullore.
- 3.7. zgjerim i veprimtarisë:
- 3.7.1. vendimi i organit vendimmarrës për ushtrimin e veprimtarisë shtesë;

- 3.7.2. dokumenti që vërteton pagesën e shumës shtesë të kapitalit minimal (nëse është e aplikueshme);
- 3.7.3. politikat dhe procedurat e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë shtesë;
- 3.7.4. planin biznesin sipas përcaktimeve në nenin 5 paragrafi 3 nënparagrafi 3.6 të kësaj rregullore dhe ndikimi në gjendjen e përgjithshme financiare të subjektit.

3.8. për hapjen dhe zhvendosjen e zyreve:

- 3.8.1. vendimin e organit vendimmarrës;
- 3.8.2. përshkrimin për arsyetimin e hapjes apo zhvendosjes së zyrës;
- 3.8.3. njoftimi me shkrim për plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë. Në këtë njoftim duhet specifikuar hapat e ndërmarra lidhur me plotësimin e këtyre kushteve si dhe fotografitë që dëshmojnë një gjë të tillë.

3.9. për mbylljen e zyreve:

- 3.9.1. identifikimin e zyrës që do të mbyllet dhe datën e propozuar të mbylljes;
- 3.9.2. vendimin e organit vendimmarrës;
- 3.9.3. raportin me arsyet e marrjes së vendimit për mbylljen e zyrës;

3.10. shitja apo transferimi (i plotë apo i pjesshëm) i veprimtarisë (portofolios) të IFJB, një entiteti tjetër;

- 3.10.1. vendimin e organit vendimmarrës për këto transaksione;
- 3.10.2. marrëveshjen e nënshkruar apo draftmarrëveshjen në mes IFJB dhe entitetit tjetër.

3.11. bashkimi dhe/ose përvetësimet:

- 3.11.1. vendimi i organit vendimmarrës të IFJB-së dhe institucionit financiar tjetër të përfshirë në veprim për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet bashkimit;
- 3.11.2. marrëveshja apo draftmarrëveshja dhe raporti i detajuar i procesit të bashkimit, të nënshkruar nga përfaqësuesit ligjor të institucioneve të përfshira në procesin e bashkimit. Marrëveshja apo draftmarrëveshja dhe raporti përpilohen me shkrim dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- 3.11.3. drafti i statutit të IFJB-së pas realizimit, të procesit të bashkimit;
- 3.11.4. planet strategjike dhe operative për të kryer bashkimin, ku përfshihen analizat e nevojshme të përvetësimit dhe parashikimet e pasqyrave financiare për IFJB-në e bashkuar;
- 3.11.5. në rast të ndryshimit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të IFJB-së së bashkuar, duhet të paraqitet dokumentacioni në përputhje me kërkesat për drejtorët siç është e përcaktuar në Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe këtë rregullore;
- 3.11.6. struktura e re e aksionarëve të IFJB-së.

3.12. shpërndarja e dividendës:

- 3.12.1. vendimin i kuvendit aksionar dhe bordi i drejtorëve për shpërndarjen e dividendës;
- 3.12.2. parashikimet lidhur me bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, kapitalin bazë, në baza mujore për 12 muajt e ardhshëm, duke reflektuar pagesën potenciale të dividendës;
- 3.12.3. pasqyrat financiare të audituara për vitin paraprak.

4. BQK-ja mund të kërkojë dokumente shtesë përveç atyre të specifikuara në paragrafin 3 të këtij neni.

5. Kërkesa për miratimin e transaksioneve të lartcekura si dhe dokumentacioni i bashkangjitur në kërkesë duhet të paraqitet nga IFJB dhe duhet të jetë në njërën nga dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja, të ndryshme nga Republika e Kosovës, dokumentacioni duhet të jetë edhe i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse të shteteve përkatëse.
6. BQK miratonë kërkesat e parashtruara nga IFJB-të për transaksionet sipas paragrafit 1 të këtij nenin, vetëm nëse plotësohet kriteret e mëposhtme:
 - 6.1. ndryshimi i emrit:
 - 6.1.1. emri i ri i propozuar i IFJB-së duhet të jete në pajtim me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.
 - 6.2. ndryshimet në dokumentin e themelimit dhe/ose statutin:
 - 6.2.1. ndryshimet nuk janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, varësisht se për çfarë ndryshimi bëhet fjalë.
 - 6.3. rritja e kapitalit aksionar:
 - 6.3.1. burim të ligjshëm të fondeve të kapitalit
 - 6.4. zvogëlimi i kapitalit aksionar:
 - 6.4.1. ndikimi i këtij zvogëlimi në IFJB, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në ndikimin që mund të ketë zvogëlimi në qëndrueshmërinë financiare të IFJB-së, strukturën e pronësisë së IFJB-së dhe përshtatshmërinë e aksionarëve.
 - 6.5. transaksionet dhe veprimet lidhur me kapitalin aksionar që sjellin te ndryshimi i listës së aksionarëve, të cilët posedojnë dhjetë përqind (10%) apo më shumë të kapitalit aksionar dhe/apo të drejtave të votës në shoqëri;
 - 6.5.1. përvetësimi i propozuar vlerësohet sipas kriterëve të njëjta që zbatohen për miratimin të një kërkesë për regjistrimit të IFJB-së sa i përket aksionarëve duke përfshirë por duke mos u kufizuar në efektet e pritura të përvetësimit të propozuar në qëndrueshmërinë financiare të IFJB-së, strukturën e pronësisë së IFJB-së dhe ndikimin që mund të ketë ky përvetësim në mbikëqyrjen e IFJB-së nga BQK.
 - 6.6. emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë:
 - 6.6.1. aplikohen kriteret e përcaktuara në nenin 12 të kësaj rregullore;
 - 6.7. zgjerimi i veprimtarisë:
 - 6.7.1. kriteret e parapara për regjistrimin e IFJB përshtatshëmrishtë do te aplikohen edhe me rastin e vlerësimit të kërkesës për miratimin e veprimtarisë shtesë të IFJB-së, varësisht nga veprimtaria shtesë për të cilën kërkohet miratim.
 - 6.8. hapja dhe zhvendosja e zyrave brenda vendit:
 - 6.8.1. ndikimi i hapjes apo zhvendosjes në komunitetin në të cilin zyra është apo do të vendoset;
 - 6.8.2. IFJB duhet t'i ofrojë BQK-së, informata dhe fakte të mjaftushme se zyra është e gatshme për të zhvilluar veprimtarinë e saj, sa i përket kushteve teknike dhe të sigurisë duke përfshirë sistemin kompjuteri, stafin, sigurimin etj.;

- 6.8.3. BQK-ja ka të drejtë të urdhërojë pezullimin e ushtrimit të veprimtarisë në zyrën përkatëse edhe pas miratimit, nëse ajo konstaton se kushtet teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e veprimtarisë financiare nuk janë përmbushur.
- 6.9. mbyllja e zyrave brenda vendit:
- 6.9.1. BQK-ja pranon se zgjerimi apo zvogëlimi i rrjetit të zyrave është vendim biznesi i vetë IFJB-së. Mirëpo, BQK-ja mund të shtyjë përkohësisht IFJB-në deri në 30 ditë kalendarike, në mbylljen e zyrës, nëse sipas gjykimit të BQK-së mbyllja e zyrës do të ketë një ndikim të madh negativ në qasjen në shërbime financiare në komunitetin e shërbyer nga ajo zyre.
- 6.10. shitja apo transferimi (i plotë apo i pjesshëm) i veprimtarisë (portofolis) të IFJB, një entiteti tjetër:
- 6.10.1. ndikimi i shitjesë apo transferimit të veprimtarisë (portofolis) të klientët e IFJB-së;
- 6.10.2. ndikimi i shitjesë apo transferimit të veprimtarisë (portofolis) në gjendjen financiare të IFJB-së;
- 6.10.3. shitja apo transferimi i veprimtarisë (portofolis) nuk shkakton efekt kundër-konkurrues;
- 6.11. bashkimi dhe/ose përvetësimet:
- 6.11.1. bashkimi ose përvetësimi nuk rrezikon gjendjen financiare të IFJB-së së bashkuar;
- 6.11.2. IFJB ka sistem të organizimit, menaxhimit, vendimmarrjes dhe teknologjisë informative e cila mundëson integrimin e plotë të IFJB-së së bashkuar ose përvetsuar në atë mënyrë që të mos e rrezikojë funksionimin e saj;
- 6.11.3. bashkimi ose përvetësimi është ekonomikisht i arsyeshëm;
- 6.11.4. bashkimi dhe/ose përvetësimi nuk shkakton efekt kundërkonkurrues;
- 6.11.5. është përgjegjësi e IFJB-së për të marrë miratime nga autoritetet e tjera që mund të jenë të nevojshme para se transaksioni të ketë përfunduar.
- 6.12. shpërndarja e dividendës.
- 6.12.1. ndikimi i shpërndarjes së dividendës në IFJB duke përfshirë por duke mos u kufizuar në efektet e pritura në qëndrueshmërinë financiare të IFJB-së.
7. BQK gjatë vendosjes për miratimin e këtyre transaksioneve, merr parasysh edhe kritere tjera në funksion të realizimit të qëllimeve të saja të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI IV TRANSAKSIONET QË KËRKOJNË NJOFTIM PËR BQK

Neni 11

Kërkesat për njoftim të ndryshimeve të IFJB

1. IFJB duhet të njoftojë BQK-në, brenda 30 ditëve nga data kur ndodhin, për transaksionet si në vijim:
 - 1.1. çdo ndryshim në pronësinë e aksionarëve që posedojnë më pak se dhjetë përqind (10%) të kapitalit;
 - 1.2. dorëheqjet e drejtoreve dhe menaxherëve të lartë;
 - 1.3. riemërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë;

- 1.4. ndryshimet në strukturën organizative, nëse ky ndryshim nuk reflektohet në statutin e IFJB-së, drejtor apo menaxher të lartë.
2. IFJB-të, menjëherë, duhet të njoftojnë në BQK rreth ngjarjeve të rrezikut operacional, nëse ndodhin ndonjë nga ngjarjet në vijim:
 - 2.1. humbjet financiare si pasojë e vjedhjeve, mashtrimeve financiare apo raste tjera të ngjashme, të cilat paraqesin humbje për IFJB-së në shumën monetare mbi 1,000 € (njëmijë euro);
 - 2.2. ngjarje, të cilat rezultojnë në dëm serioz ose humbje të të dhënave të rëndësishme të IFJB-së, librave të saj, ndërprerje të operacioneve për më tepër se tri orë në dy apo më tepër zyre, apo ndërprerje të operacioneve për më tepër se pesë orë në një zyre dhe e cila ndikon në operacionet normale të IFJB-së;
 - 2.3. informatat ekskluzive të IFJB-se janë vjedhur, shitur apo publikuar pa lejen e IFJB-së apo ndonjë informacion i humbur i cili mund ta dëmtoj stabilitetin financiar të IFJB-së;
 - 2.4. shkelje e shpeshtë e rregullave të aplikueshme nga menaxhmenti i lartë.

KAPITULLI V

ORGANIZIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKARE

Neni 12

Qeverisja në IFJB

1. IFJB-ja duhet të veprojë në përputhje me parimet e pranuar të qeverisjes së mirë për të siguruar, që biznesi i institucionit realizohet në mënyrë të sigurtë dhe të shëndoshë. Qeverisja në IFJB duhet të jetë në pajtueshmëri me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare si dhe me këtë rregullore.
2. Sikurse përcaktohet me nenin 97 paragrafi 1 të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, IFJB-të duhet të kenë bord të drejtoreve që përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) anëtar, nga të cilët shumica duhet të jenë drejtor të pavarur dhe jo ekzekutiv.
3. Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të plotësojnë kriteret “i përshtatshëm dhe i duhur” siç kërkohet nga BQK-ja.
4. Drejtorët dhe menaxherët e lartë të institucionit financiar jobankar, duhet të plotësojnë të paktën kriteret e mëposhtme:
 - 4.1. të kenë diplomë universitare në ekonomi, jurisprudencë ose fushë tjetër relevante;
 - 4.2. të kenë përvojë profesionale jo më pak se 3 (tre) vjet në sektorin bankar dhe/ose financiar ose në ndonjë fushë tjetër të konsideruar të përshtatshme nga BQK;
 - 4.3. të kenë reputacion të lartë etik dhe profesional;
 - 4.4. të mos jenë të larguar nga posti në një institucion financiar nga BQK-ja;
 - 4.5. nuk është dënuar nga një gjykatë penale për vepër penale për të cilën është percaktuar dënim me burgim prej një viti a më shumë, për të cilat nuk është percaktuar opsioni i gjobës;
 - 4.6. personi që nuk është i dënuar për krime ekonomike ose që nuk është gjetur fajtor për vepra penale ekonomike sipas Kodit Penal;

- 4.7. personi të cilit, sipas vendimit të gjykatës i është mohuar ushtrimi i veprimtarive në kuadër të kompetencave të përcaktuara për drejtorët dhe menaxherët e lartë;
 - 4.8. nuk është përjashtuar ose suspenduar nga autoriteti kompetent nga ushtrimi i profesionit për shkak të sjelljes së pahijshme personale;
 - 4.9. të mos kenë shkaktuar ose të mos kenë qenë përgjegjës për falimentimin e ndonjë subjekti që ushtron aktivitet ekonomik;
 - 4.10. të mos kenë qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese përfshirë administrimin zyrtar ose falimentimit, si dhe të jenë të çliruar nga pagesa e detyrimeve pasurore të kaluara.
5. Në rrethana të veçanta, pasi që të jetë e kënaqur me kualifikimet, përvojën profesionale dhe sjelljen e personit, BQK-ja mund ta lirojë një drejtor ose menaxher të lartë nga dispozitat e nënparagrafit 4.10 të paragrafit 4 të këtij neni.
 6. IFJB që ushtrojnë vetëm veprimtarinë e këmbimit të valutave qeverisjen mund ta kenë të organizuar në pajtueshmëri me statutin e institucionit.
 7. Menaxherët e institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë e vetëm të këmbimit të valutave duhet minimum të kenë shkollimin e mesëm dhe të njohin veprimtarinë e këmbimit valutor.
 8. Komitetet e Bordit të Drejtorëve të IFJB-ve përbëhen vetëm nga anëtarët e Bordit të Drejtorëve, me përjashtim të Komitetit të Auditimit në të cilin së paku një anëtar i këtij komiteti duhet të jetë një ekspert i jashtëm në fushën e kontabilitetit ose auditimit.
 9. BQK mund të kërkojë nga IFJB-të të kenë komitete shtesë përveç atyre të përcaktuara në Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.
 10. IFJB-të mund të themelojë komitete shtesë përveç atyre të përcaktuara në Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare si dhe komitete tjera në kuadër të menaxhementit të lartë.

KAPITULLI VI DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 13 Të tjera

1. IFJB-të apo agjentët e tyre nuk lejohen të bëjnë reklamë identifikuese për institucionin para regjistrimit/miratimit nga BQK-ja.
2. BQK-ja mund të kryejë inspektim në vend të IFJB-së apo agjentëve e tyre para fillimit të veprimtarisë për të cilën është regjistruar. Qëllimi i këtij ekzaminimi është të vlerësojë nëse zyra në fjalë ka krijuar kushte për të përmbushur detyrimet e përcaktuara me kushtet teknike dhe të sigurisë së ambienteve në të cilat IFJB do të ushtroj veprimtarinë.
3. BQK-ja në çdo kohë mund të inspektojë zyret/agjentët që kryejnë veprimtari financiare, me qëllim verifikimin e plotësisë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara me ligj dhe këtë rregullore.
4. IFJB duhet të vendosin certifikatën e tyre të regjistrimit nga BQK-ja në një vend të dukshëm në zyrën/zyrat e tyre.

5. Në rastet e kërkesave për veprimtaritë e tjera të IFJB të parapara me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare do të aplikohen përshtatshëm dispozat e kësaj Rregulloreje.

Neni 14 **Rregulloret e aplikueshme**

1. Rregulloret e BQK-së, në vijim zbatohen përshtatshëm (me ndryshime të domosdoshme) për IFJB, për derisa të përcaktohet ndryshe nga BQK-ja:
 - 1.1. Rregullore për letërkredinë dhe garancionin bankar;
 - 1.2. Rregullore për Sistemin e Numrave Standardë të Llogarive Bankare.
 - 1.3. Rregullore për instrumentet e pagesave elektronike
 - 1.4. Rregullore për kërkesat minimale të sigurisë;

Neni 15 **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkimeve administrative, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Ligjin për Bankat, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare si dhe Ligjin për Sistemin të Pagesave.

Neni 16 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja për regjistrimin, mbikëqyrjen dhe veprimtaritë e institucioneve financiare jobankare, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 28 maj 2015.

Neni 17 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2020.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës